

20050460682

L I G J I
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR GARANCI TË REPUBLIKES
SË MAQEDONISE SIPAS MARREVESHJES FINANCIARE PËR HUA QË DO TË
LIDHET NDERMJET BANKES EVROPIANE PËR INVESTIME DHE
ELEKTROEKONOMISE SË MAQEDONISE SH.A. PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT
PËR NDERTIM TË TRAFOSTACIONEVE NË REPUBLIKEN E MAQEDONISE

Neni 1

Në Ligjin për garanci të Republikës së Maqedonisë sipas Marreveshjes financiare për hua që do të lidhet ndërmjet Bankes Evropiane për Investime dhe Elektroekonomise së Maqedonisë Sh.A. për realizimin e Projektit për ndërtim të trafostacioneve në Republikën e Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”nr. 72/2003), titulli i Ligjit ndryshon si vijon”:

“Ligji për garanci të Republikës së Maqedonisë sipas Marreveshjes financiare për hua që do të lidhet ndërmjet Bankes Evropiane për Investime dhe Elektroekonomise së Maqedonisë Sh.A. për realizimin e Projektit për ndërtim të trafostacioneve në Republikën e Maqedonisë dhe Amendamentit 1 të Marreveshjes financiare për hua që do të lidhet ndërmjet Bankes Evropiane për Investime dhe Operatorit të sistemit elektropërcues të Maqedonisë, shoqëri aksionare për përcimin e energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik, në pronësi shtetërore (ShA EPMSO)”.

Neni 2

Neni 1 ndryshon si vijon:

“Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve sipas Marreveshjes financiare për hua për realizimin e Projektit për ndërtim të trafostacioneve në Republikën e Maqedonisë të lidhur ndërmjet Bankes Evropiane për Investime dhe Elektroekonomise së Maqedonisë Sh.A. në shumë prej 13 milione eurosh, si dhe sipas Amendamentit 1 të Marreveshjes financiare për hua që do të lidhet ndërmjet Bankes Evropiane për Investime dhe Operatorit të sistemit elektropërcues të Maqedonisë, shoqëri aksionare për përcimin e energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik, në pronësi shtetërore (ShA EPMSO)”.

Neni 3

Në nenin 2 fjalet ”do të” zëvendësohen me fjalen “jane”.

Neni 4

Në nenet 3, 4 dhe 5, fjalet “Elektroekonomia e Maqedonisë Sh.A.” zëvendësohen me fjalet “Operatori i sistemit elektropërcues të Maqedonisë, shoqëri aksionare për përcimin e energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik, në pronësi shtetërore (ShA EPMSO)”.

Neni 5

Ministria e Financave dhe ShA EPMSO do të lidhin marreveshje me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella mbi baze të garancisë së dhënë pranë Bankes Evropiane për Investime, nga neni 2 i këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e ardhshme pas dites së shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.